



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400964/5

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë të merren masa organizative dhe procedurale për përfundimin e gjykimit të çështjes penale Nr.1055 akti, datë 08.11.2013 të Gjykatës Apelit Vlorë.*

Drejtuar : Zj. Alma LIÇAJ
Kryetare e Gjykatës së Apelit

VLORË

Për dijëni : Zj.Marsida XHAFERLLARI
K/Inspektore e KLD-së

TIRANË

E nderuar Zj. Kryetare,

Në ankesën e tyre të përsëritur datë 15.05.2014 drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasit K., A. dhe E. D. nga qyteti i Lushnjes që janë në të njëjtën kohe edhe të afërm të viktimës J. D. e cila ka gjetur vdekjen nga aksidenti rrugor i kryer me datën 05.06.2012 nga i pandehuri L. S., parashtrojnë se Gjykata e Apelit Vlorë po zvarrit pa shkaqe ligjore gjykimin e kësaj çështje penale.

Ankuesit gjithashtu pretendojnë se Gjykata e Apelit Vlorë, në rastin konkret nuk po zhvillon një gjykim të drejtë dhe publik dhe brenda një afati të arsyeshëm parashikuar, nga neni 42/2 i Kushtetutës i Republikës së Shqipërisë.

Ankuesit pretendojnë se gjyqtarët e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnje me vendimin e saj datë 02.10.2013 kanë vendosur deklarin e pafajshëm të pandehurit L. S. i akuzuar për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor parashikuar nga neni 290/1 të K.Penal.

Nga verifikimi ynë rezultoi se nga Gjykata e Apelit Vlorë deri tani janë zhvilluar disa seanca gjyqësore dhe konkretisht me datën 29.04.2014, me datën 14.05.2014, me datën 21.06.2014, me datën 11.06.2014 dhe séance e fundit gjyqësore është shtyrë me datën 03.07.2014, dhe ky gjykim nuk ka përfunduar akoma.

Duke analizuar shkaqet e këtyre shtyerjeve të këtyre 5 seancave gjyqësore dhe duke analizuar shqetësimet e drejta dhe të ligjshme të ankuesve që përfaqësojnë të drejtat dhe interesat e viktimës J. D. si dhe duke u bazuar

në ankesat e përsëritur të familjes së viktimës nga vepra penale u gjykua nga institucioni ynë që në rastin konkret të ndërhyhet pranë jush me rekomandim duke kërkuar marrjen e masave për shpejtimin dhe përfundimin e këtij gjykimi.

Kjo ndërhyrje institucionale bëhet edhe për faktin se duke u analizuar koha e ndodhjes së ngjarjes ose e kryerjes së veprës penale të ndodhur dhe koha e gjykimit të saj në Gjykatën e Apelit Vlorë, kanë kaluar rreth dy vjet, dhe duke u bazuar në disa vendimet të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, dhe të Gjykatës Kushtetuese në vendin tone, të cilat janë jurisprudenca të detyrueshme për tu respektuar nga organet gjyqësore, në këto vendime deklarohet me forcë qartë se: **“Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”**, rekomandojmë Gjykatës së Apelit Vlorë që të shikohen të gjitha mundësit ligjore të shpejtit të procedurave gjyqësore për përfundimin e kësaj çështje penale në të ardhmen.

E drejta për tu gjykuar para një gjykate kompetente të pavarur dhe të paanëshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet por ajo duhet të shihet se po bëhet.

Në këto kushte dhe bazuar në nenin 60/3 të Kushtetutës së R.SH, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike”, dhe nga neni 25 i Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e popullit ku parashikohet se: “Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa apo njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

Për sa sipër, Ju

REKOMANDOJMË :

1. Të shikohet mundësia proceduriale dhe ligjore e përfundimit të gjykimit të çështjes penale Nr.1055 akti , datë 08.11.2013 nga Gjykata e Apelit Vlorë.

2. Mbi qëndrimin që do mbahet në lidhje me këtë rekomandim dhe masat e marra nga ana e juaj lutemi në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, na njoftoni me shkrim brenda 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI